

VENDIM
Nr.401, datë 19.5.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.5, DATË 6.1.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE
TË PROCEDURAVE PËR PËRFITIMET NGA PROGRAMI I GRANTEVE TË
RINDËRTIMIT DHE PROJEKTET MODEL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18, 19, 20 e 25, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun IV, të vendimit nr.5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “b”, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) projektin e rikonstruksionit ose listën e punimeve të riparimit dhe preventivin e punimeve që kërkohen të financohen nëpërmjet grantit për individët ose familjet që përfitojnë vlerën e plotë të rikonstruksionit, sipas pikës 3, të këtij kreu, hartuar nga Instituti i Ndërtimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo projektuesit e licencuar.”.

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Masa e vlerës së rikonstruksionit ose riparimit, kontrata tip për përfitim nga grantet e rikonstruksionit për individët ose familjet, sipas pikës 4, të këtij vendimi, miratohen me vendim të këshillit bashkiak të njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila, në të gjitha rastet, nuk duhet të jetë më shumë se:”.

c) Në shkronjën “b”, të pikës 7, pas fjalës “... e vlerës ...” shtohen fjalët “... të preventivit të punimeve ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shtetit për Rindërtimin, Enti Kombëtar i Banesave dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama